



ALMA MATER EUROPAEA  
CAMPUS COLLEGE "REZONANCA"

Tel.+383 38 544-754  
Fax: +383 38 544-756

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

---

Nr.Prot. :	AD-1493-8/21
Datë :	31.03.2022

Mbështetur në nenin 77, paragrafi 2 të Statutit të Alma Mater Europaea Campus College Rezonanca (AMECCR), në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, Ligjit të Punës Nr. 03/L-2012, Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Abneksi I- MASHT) Nr. 7/2018 e UA Nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, Senati i AMECCR, në mbledhjen e datës 10.12.2021, miratoi këtë :

## **RREGULLORE**

### **Për procedurat lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Kolgjin Alma Mater Europaea Campus College Rezonanca**

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në thirrje akademike në të gjitha Fakultetet e Kolegjit.
2. Nëpërmjet dispozitave të kësaj Rregulloreje, rregullohen të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht në Statutin e Kolegjit lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në thirrje akademike.

Neni 2

Personeli akademik

Në pajtim me nenin 75, pika 2, të Statutit të Kolegjit, personeli akademik i Kolegjit përbëhet nga: Profesorë të rregullt (Prof.), Profesorë të asocuar (Prof. Asoc.), Profesorë asistentë (Prof. Ass.), Ligjërues (Ligj.), Asistentë (Ass.), Asistentë të rinjë (Ass. i ri) dhe Mentorë klinikë (Ment.kl.).

### Neni 3

Kriteret për emërimin në thirrje akademike

1. Procedurat vlerësuese për emërim në thirrje akademike mbështet në vlerësimin e aktiviteteve si në vijim:

a. Aktiviteti arsimor (mësimdhënia)

b. Aktiviteti hulumtues, shkencor dhe profesional

c. Aktivitet shërbyes.

2. Te aktiviteti arsimor vlerësohet: aktiviteti mësimor me përqendrim te përvoja relevante, cilësia e mësimdhënies, trajnimet në mëimdhënie, shpërblimet dhe mentorimi.

3. Te aktiviteti hulumtues, shkencor dhe profesional vlerësohen: publikimet e stafit sipas nenit xx të kësaj Rregulloreje.

4. Te aktiviteti shërbyes vlerësohen: shërbimet në lidhje me Kolegjin, shërbimet në lidhje me Fakultetin dhe shërbimet në lidhje me Komunitetin.

### Neni 4

Aktiviteti hulumtues, shkencor dhe professional i personelit akademik

1. Punimet e publikuara në revista ndërkombëtare shkencore mund të shfrytëzohen për nevoja të emërimit, riemërimit dhe avancimit nga autori i parë i punimit dhe nga autori correspondent.

2. Për autorin korrespondent të punimit të publikuar vlejné këto kriteret:

a. Si autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar s ii tillë në punimin e publikuar;

b. Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se një autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar s ii tillë;

c. Nëse në punimin e publikuar nuk është identifikuar autorikorrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i dytë i punimit;

d. Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është identifikuar, si autor korrespondent konsiderohet autori i dytë i punimit.

## Neni 5

Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare

1. Bazuar në UA (MASHT) Nr.01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension dhe Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Abneksi I- MASHT) Nr. 7/2018 e UA Nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, gjatë vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, vlej punimet e publikuara në lëmin e kandidatit, në revista të cilat janë të indeksuara në bazat përkatëse akademike të kategorizuara si në vijim:

a. Punimet e publikuara në revistat të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me koeficient të publikimeve 1:

a.1. Web of Science (<http://mjl.clarivate.com>)

a.2. Scopus (Elsevier) (<http://www.scopus.com>)

a.3. EBSCOhost (<http://www.ebscohost.com/academic>)

a.4. WorlCat (<http://www.worldcat.com>)

a.5. Directory of Open Access Journals (<http://www.doaj.org>)

b. Punimet e publikuara në revistat të cilat janë të indeksuara në tre platformat akademike të përcaktuara nga Senati barasvlerësohen me koeficient të publikimeve 0.85:

b.1. WorldWideScience (<http://www.worldwidescience.org>)

b.2. Microsoft Academic Search (<http://academic.research.microsoft.com>)

b.3. BASE (Bielefeld Academic Search Engine) (<http://www.base-search.net>)

c. Punimet e publikuara në revistat të cilat janë të indeksuara në dy platformat akademike të përcaktuara nga Këshilli i Fakulteteve barasvlerësohen me koeficient të publikimeve 0.70:

- c.1. PubMed (<http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed>)
  - c.2. ProQuest (<http://www.proquest.com/libraries/academic/databases>)
  - c.3. ERIC-Education Research Information Center (<http://eric.ed.gov/>)
  - c.4. ERIH PLUS (<http://dbh.nsd.uib.no/publiseringskanaler/erihplus>)
- d. Punimet e publikuara në revistat shkencore vijuese të përcaktuara nga departamentet barasvlerësohen me koeficient të publikimeve 0.55:

#### Neni 4

##### Emërimi në thirrjet akademike

1. Në pajtim me nenin 78, 79, 80 dhe 81 të Statutit të Kolegjit, për emërimin e personelit në thirrjet akademike profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent dhe ligjërues, kandidati, duhet t'i plotësojë të gjitha kualifikimet që dalin nga këto dispozita të Statutit të Kolegjit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë.
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose korrespondent i punimeve të publikuara nëse plotësohen kriteret specifike sipas nenit xx, paragrafi xx të kësaj rregulloreje.

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet në tituj akademikë si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në pajtim me dispozitat përkatëse të Statutit të Kolegjit
2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritor për të gjitha pozitat.
3. Për kategoritë e mësimdhënësit tituli i parë që fitohet është Prof.asistent, përkatësisht ligjërues, nëse është nevojë reale e Kolegjit.
4. Titulli akademik i fituar në Kolegj mund të revokohen nga ana e Senatit të Kolegjit nëse me arsye dhe argumente të forta verifikohet:
  - a. Falsifikimi apo mashtrimi gjatë vlerësimit ose provimit;

b. Plagjiatura apo shkelja e të drejtave të autorit në përgatitje e temës së diplomës apo të punimeve të tjera me shkrim;

c. Praktika joetike.

5. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi të Republikës së Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

## Neni 6

### Procedurat e konkursit

1. Të gjitha procedurat e konkursit për emërimin, riemërimin ose avancimin e personelit akademik bëhen në mënyrë transparente në pajtim me dispozitat përkatëse të Statutit të Kolegjit dhe Ligjit të Punës.

2. Kolegji nuk shpallë konkurs për pozitat të cilat lidhen me personelin akademik të rregullt, të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pensionim, përveç në rastet kur rrezikohet akreditimi i programit përkatës.

3. Personelit në marrëdhënie të rregullt pune sipas pikës 2 të këtij neni, Rektori, me vendim, i vazhdon kontratën për periudhën e mbetur deri në pension.

4. Rektori, me arsyetim të bazuar, mund të vendosë t'i propozojë Senatit shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të caktuara të punës për personelin akademik, edhe nëse ai vend pune nuk është paraparë me propozim të Fakultetit.

5. Konkursi shpallet në web-faqen e Kolegjit në kohëzgjatje pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.

6. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur, në Fakultetin përkatës dhe në formë elektronike, në adresën zyrtare të Kolegjit.

## Neni 7

### Komisionet vlerësuese dhe të ankesave

1. Për çdo pozitë të shpallur në Konkurs Kolegji cakton komisionin vlerësues, si dhe komisionin e ankesave, me kredibilitet të lartë profesiona, akademik dhe etik.

2. Komisionet sipas pikës 1 të këtij neni, me nga 3 anëtarë nga radhët e profesorëve në nivel të Fakultetit/Departamentit, caktohen në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit, të thirrur nga dekani, shtatë (7) ditë pas hapjes së konkursit.
3. Anëtarë të Komisionit të ankesave nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të Fakultetit dhe departamenteve përkatëse si dhe anëtarët e komisioneve vlerësuese.
4. Në komisione vlerësuese dehet të jetë së paku një (1) anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndën për të cilën është hapur konkursi.
5. Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të kenë titull më të lartë akademik ose së paku të njëjtë me pozitën për të cilën ka aplikuar kandidati.
6. Kryetar i komisionit vlerësues është anëtari i komisionit me titullin më të lartë akademik. Nëse më shumë se një anëtarë i komisionit vlerësues ka titull më të lartë akademik, përkatësisht në rastet kur të gjithë anëtarët e komisionit kanë titull të njëjtë akademik, kryetar do të jetë anëtari më i vjetër me moshës, përkatësisht anëtari i caktuar me konsensus.
7. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në pikën 4 dhe 5 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorët nga departamentet tjera, por në këtë rast kryetar i komisionit është profesori nga departamenti për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet.
8. Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga institucione të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm. Kur komisioni vlerësues ka dy (2) anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm me autorizim është kryetar i komisionit.
9. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve në marrëdhënie të rregullt punë si në pikën 4 dhe 5 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorët e pensionuar nga lëmi përkatës, të cilët nuk kanë kaluar moshën 70 vjeçare, përkatësisht profesorët emeritus, të cilët kanë kontratë për mbajtjen e mësimin edhe mbi këtë moshë.
10. Anëtari i komisionit Brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas formimit të komisionit vlerësues, mund të deklarojë me shkrim tërheqjen e tij nga komisioni me arsye të bazuara. Dekani i Fakultetit Brenda shtatë (7) ditëve thërret mbledhjen e Këshillit të Fakultetit dhe në rast të aprovimit të dorëheqjes, kërkon kooptimin e anëtarit në komision.
11. Komisionit vlerësues të gjitha dokumentacionet e nevojshme i ofrohen ang administrata e Kolegjit.

12. Kryetari i komisionit vlerësues it hërret anëtarët e tjerë të komisionit dhe e hartojnë raportin e vlerësimit, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas mbylljes së konkursit.

13. Nëse komisioni vlerësues nuk ka respektuar afatet e parapara në këtë Rregullore Këshilli i Fakultetit ka të drejtë të ndryshojë përbërjen e komisionit vlerësues. Komisioni i ri duhet që brenda dhjetë (10) ditëve të hartojë dhe dorëzojë raportin për kandidatët e paraqitur në konkurs.

14. Gjatë punës Komisioni vlerësues duhet të respektojë dispozitat ligjore, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, Statutin e Kolegjit, këtë Rregullore dhe kushtet e Konkursit.

15. Komisioni vlerësues duhet t'i japë përparësi kandidatëve të cilët më së miri i plotësojnë kriteret për emërim, riemërim ose avancim. Komisioni duhet të arsyetojë rekomandimin e bërë. Për kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të ceken kushtet të cilat nuk janë plotësuar.

16. Raportin final, të nënshkruar nga të tre anëtarët e komisionit vlerësues e dorëzon kryetari i komisionit për aprovim në Këshillin e Fakultetit përkatës.

17. Nëse ndonjë nga anëtarët e komisionit vlerësues ka mendim të ndryshëm, duhet të paraqesë "propozim të ndarë" për Këshillin e Fakultetit përkatës.

18. Këshilli i Fakultetit, jo më larg se shtatë (7) ditë pas dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues, diskuton propozimin e komisionit, përkatësisht diskuton të dy propozimet, nëse plotësohen kushtet sipas pikës 17 të këtij neni, dhe e miraton propozimin. Këshilli i Fakultetit mund të refuzojë propozimin, përkatësisht të dy propozimet, në rastet e plotësimit të pikës 17 të këtij neni, por nuk mund të miratojë të dy propozimet për të njëjtën pozitë.

19. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin vlerësues.

## Neni 8

### Procedura pas dorëzimit të raportit nga Komisioni vlerësues

1. Këshilli i Fakultetit, brenda tre (3) ditëve nga dita e miratimit të raportit vlerësues, e përcjell verzionin elektronik të raportit në Zyrën për Çështje Akademike të Kolegjit.

2. Zyra për Çështje Akademike e Kolegjit, Brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së raportit, e harton Buletinin dhe të njëjtin e përcjell në Qendrën Kompjuterike të Kolegjit për publikim në web-faqe të Kolegjit.
3. Buletini qëndron i publikuar në web-faqe pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit
4. Zyra për Çështje Akademike e Kolegjit, nëse konstaton se raporti id orëzuar nuk është me rregull me dokumentacion, atëherë duhet të kërkojë nga Prorektori për mësim që ta obligojë Fakultetin përkatës që të kompletojë dokumentacionin para se të dalë në Buletin.
5. Gjatë kohës së publikimit të Buletinit, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë pranë Komisionit të ankesave. Ankesat dorëzohen në administratën e Fakultetit përkatës.
6. Pas kalimit të afatit të Buletinit, Këshilli i Fakultetit, në afat prej dhjetë (10) ditësh, vlerëson raportet e Komisioneve vlerësuese, duke shqyrtuar edhe raportin e Komisionit të ankesave, dhe vendosë për miratim ose jo të raporteve.
7. Komisioni i ankesave, brenda tre (3) ditëve duhet të shqyrtojë ankesat e parashtruara gjatë fazës së publikimit të Buletinit dhe ndaj ankesave të japë përgjigje me shkrim. Komisioni i ankesave, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh duhet të dorëzojë raportin për shqyrtim në Këshillin e Fakultetit përkatës. Raportin e dorëzon në Zyrën për Çështje Akademike të Kolegjit.

## Neni 9

### Shqyrtimi i propozimit të Këshillit të Fakultetit në Senat

1. Senati i Kolegjit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej marrjes së propozimit nga Këshilli i Fakultetit, merr vendim për miratim ose refuzim të propozimit të Këshillit të Fakultetit. Në rast se propozimi i Këshillit të Fakultetit refuzohet, lënda, brenda tre (3) ditëve kthehet për rishqyrtim në Këshillin e Fakultetit.
2. Këshilli i Fakultetit, brenda shtatë (7) ditëve pas pranimi të vendimit të Senatit për rishqyrtim të lëndës dhe rivlerësim, dorëzon vendimin përkatës në Zyrën për Çështje Akademike të Kolegjit.
3. Nëse Këshilli i Fakultetit, edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar, Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i tyre.



4. Procedura e votimit në Senat për propozimet e Këshillit të Fakultetit lidhur me emërimin dhe avancimin e personelit akademik bëhet sipas Rregullores së Punës të Senatit.
5. Stafi akademik i cili ka vlerësim pozitiv nga instancat paraprake, por i cili nuk i fiton votat e nevojshme të anëtarëve të Senatit për avancim, riemërohet në titullin akademik që ka.
6. Ndaj vendimit të Senatit në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimin në dorëzim të vendimit, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që shërben si instancë e fundit e ankimit në Kolegj.
7. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit afati i gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimumin për tridhjetë (30) ditë.
8. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi brenda afatit të përcaktuar, atëherë vendet e porealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së Fakultetit.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryesues i Senatit të Alma Mater Europaea

Campus College Rezonanca

Acad.Prof.Dr. Arian R. Idrizaj, MD, Rektori i Kolegjit

